



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5485 prot.

Himarë, më 17.07.2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për Planin Vendor për Barazinë Gjinore
2026–2028 të Bashkisë Himarë ”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ✓

Po ju dërgojmë për miratim projektvendimin “Për Planin Vendor për Barazinë Gjinore
2026–2028 të Bashkisë Himarë ”

Bashkëngjitur projektvendimi dhe relacioni sqarues për këtë projektvendim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 5485 prot.

Himarë, më 17.07.2025

PROJEKTVENDIM

NR. 35 DATË 17.07.2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2026–2028 TË
BASHKISË HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, shkronja “k”; dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”; dhe të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Të miratohet Plani Vendor për Barazinë Gjinore i Bashkisë Himarë për periudhën 2026–2028, si dokument strategjik për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat, programet dhe shërbimet publike vendore. Ky plan përbën një angazhim institucional për garantimin e të drejtave të barabarta për gra dhe burra, vajza dhe djem, dhe synon promovimin e pjesëmarrjes së barabartë në jetën sociale, ekonomike dhe politike, si dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë, Drejtoria e financës dhe planifikimit të buxhetit dhe strukturat e tjera përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe raportimin periodik mbi progresin e realizimit të këtij plani, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak dhe aktorët komunitarë.

4. Efektet financiare për realizimin e masave të parashikuara në plan do të mbulohen nga buxheti vjetor i bashkisë, si dhe nga burime të tjera të legjitimuar sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë fondet e partnerëve zhvillimorë dhe donatorëve.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORI

Aida Halilaj



DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5485/prot.
2

Himarë, më 17.07.2025

RELACION SQARUES

Lënda: “Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028 të Bashkisë Himarë”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Nisur nga nevoja për të promovuar barazinë gjinore dhe për të përmirësuar pozicionin e grave dhe vajzave në të gjitha fushat e jetës publike dhe private në territorin e Bashkisë Himarë, është hartuar Plani Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028, si një dokument strategjik në funksion të garantimit të të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë.

Barazia gjinore përbën një nga objektivat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm dhe një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë vendore. Ky plan përbën një instrument të rëndësishëm për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikatat dhe shërbimet publike të Bashkisë Himarë. Ai synon të promovojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore, duke adresuar sfidat që përballen gratë dhe vajzat në komunitet, përfshirë dhunën me bazë gjinore, pabarazinë ekonomike, mungesën e përfaqësimit në vendimarrje dhe mungesën e aksesit të barabartë në shërbime dhe burime.

Plani përmban masa konkrete për:

- fuqizimin e grave dhe vajzave në jetën publike dhe ekonomike,
- integrimin e barazisë gjinore në procesin e buxhetimit dhe vendimarrjes,

- përmirësimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës,
- nxitjen e rolit të burrave dhe djemve në promovimin e barazisë gjinore,
- dhe forcimin e mekanizmave institucionalë për monitorimin dhe raportimin e progresit.

Përmes këtij plani, Bashkia Himarë angazhohet të ndërmarrë veprime konkrete që do të ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e një mjedisi më të drejtë, më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie. Për sa ju parashtroam në këtë relacion, bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, kërkojmë miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028 nga ana e Këshillit Bashkiak.

Faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORI

Aida Halilaj

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5485/3 Prot.

Himarë, më 17.07.2025

PLANI VENDOR I BARAZISË GJINORE
2026-2028



Tabela e përmbajtjes	
Parathënie.....	2
Falenderime.....	3
Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike	4
Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë	6
Demografia	6
Analfabetizmi.....	8
Niveli Arsimor	9
Statusi martesor.....	11
Statusi i nënës	13
Frekuentimi i çerdhes.....	14
Frekuentimi i Kopshtit	16
Persona me Aftësi të Kufizuar	17
Situata e shërbimeve sociale	20
Metodologjia.....	21
Vizioni dhe objektivat strategjike	23
Qëllimet dhe objektivat strategjike	23
Qëllimi Strategjik 1 (Q1):	23
Qëllimi Strategjik 2 (Q2):	24
Plani i Veprimit	26
Qëllimi strategjik 1:	26
Objektivi Specifik (O1.1).....	26
Objektivi Specifik (O1.2).....	28
Objektivi Specifik (O1.3).....	29
Qëllimi strategjik 2:	31
Objektivi Specifik (O2.1).....	31
Objektivi Specifik (O2.2).....	35
Objektivi Specifik (O2.3).....	39
Objektivi Specifik (O2.4).....	40
6. Monitorimi dhe raportimi	42



Parathënie

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave kanë qenë prej kohësh objektiva të rëndësishëm. Për të avancuar më tej në përmbushjen e tyre në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, kemi hartuar Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Ky dokument strategjik është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, të zhvilluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të drejtuesve e specialistëve të bashkisë dhe njësive administrative, përfaqësuesve të komunitetit, institucioneve arsimore, shëndetësore, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve të Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë me mbështetjen teknike të Smart Processes.

Plani vendor për barazinë gjinore 2026 – 2028 bazohet në analizën e nevojave lokale dhe përvojës nga zbatimi i politikave të mëparshme, duke marrë në konsideratë praktikën më të mira dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Në këtë plan janë parashikuar masa të qarta për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, promovimin e barazisë gjinore midis grave dhe burrave, përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbime për gratë e burrat, si dhe për adresimin e dhunës me bazë gjinore në komunitetin tonë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cënuara, si gratë në zonat rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara apo ato që kanë përjetuar dhunë.

Bashkia mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen. Ne besojmë se për të arritur këtë vizion, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët e shoqërisë. Prandaj, ftojmë të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani.

Angazhimi ynë, drejt një bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!



Falenderime

Bashkia Himarë shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Himarës, i cili ka mbështetur këtë proces nëpërmjet angazhimit të Komisionit për Barazinë Gjinore dhe Aleancës së Grave Këshilltare, duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.



Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike

Në nivel lokal, kuadri ligjor dhe institucional që udhëheq përpjekjet për barazinë gjinore në bashki ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18/2, garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”: Ky ligj përcakton parimet themelore të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe promovon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës publike. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për mbledhjen e statistikave gjinore dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e politikave gjinore në nivel vendor.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: Ky ligj i njeh bashkive një rol kyç në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore. Neni 6 i këtij ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Neni 62 u kërkon bashkive të respektojnë parimin e barazisë gjinore në emërimet në pozita drejtuese si nënkryetarë bashkie dhe administratorë njësisht.

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”: Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor vendor. Ai kërkon që ndarja dhe përdorimi i fondeve të buxhetit të orientohen drejt garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra, si dhe ofron fleksibilitet për të financuar politika që adresojnë nevojat gjinore.

Ligji nr. 57/2016 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si një nga parimet e sistemit buxhetor. Kjo mbështet integrimin gjinor në planifikimin dhe menaxhimin financiar vendor.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili përcakton detyrimet e bashkive për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

Ligji nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor dhe e obligon pushtetin vendor të marrë masa për promovimin e barazisë.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, i cili përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të marginalizuara në nivel lokal.

Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”, i cili krijon mundësi për punësimin e grave në situata të pafavorshme përmes nxitjes së iniciativave lokale.



Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, që sanksionon parimin e barazisë gjinore dhe garanton përfshirjen e vajzave të reja në jetën politike dhe sociale të bashkisë.

Kodi i Punës, me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2020, që detyron institucionet publike vendore të sigurojnë mjedis pune pa ngacmime dhe diskriminim për shkak të gjinisë. Ligji nr. 104/2014 për sigurimet shoqërore, që përfshin të drejtën e lejes prindërore për burrat dhe nënat që rikthehen në punë.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që siguron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të marginalizuara.

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, që përcakton mbështetje për gratë viktimat të dhunës në familje dhe trafikimit përmes banesave sociale.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021, shërben si dokumenti udhëzues kryesor për këtë plan. Ajo orienton objektivat dhe masat strategjike për promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë (si CEDAW, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit, Objektivin e Zhvillit të qëndrueshëm 5, etj.).

Bashkia, nëpërmjet këtij Plani, harmonizon politikat vendore me këtë dokument kombëtar dhe merr përgjegjësi për zbatimin e tij në nivel lokal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik siguron themelin mbi të cilin Bashkia ndërton dhe zbaton politika të integruara për barazi gjinore, përfshirje dhe drejtësi sociale.

Plani është i harmonizuar me:

- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 dhe 10
- Programin Kombëtar të Integritimit Evropian



Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë

Bashkia Himarë ndodhet në pjesën jug-perëndimore të Shqipërisë, përgjatë bregdetit Jon. E njohur për peizazhet e saj natyrore mahnitëse dhe trashëgiminë e pasur kulturore, Himara është një nga destinacionet kryesore turistike në rajon. Bashkia karakterizohet nga një bashkëjetesë e harmonishme mes komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, duke ruajtur traditat dhe identitetin unik të zonës.

Bashkia Himarë përfshin 3 njësi administrative:

Njësia Administrative	Tipologjia
Himarë	urban
Horë-Vranisht	rural
Lukovë	rural

Burimi i të dhënave: INSTAT

Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth 8,328 **banorë**, me një shpërndarje të popullsisë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Në aspektin social, bashkia është përballur me sfida që lidhen me migrimin e të rinjve, papunësinë, dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve sociale, në veçanti për grupet më vulnerabël si gratë, të moshuarit, dhe personat me aftësi ndryshe.

Bashkia Himare është e angazhuar në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke promovuar vlera si transparenca, barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, hartimi i **Planit të Barazisë Gjinore** përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

Demografia

Tabela më poshtë paraqet popullsinë e bashkise sipas gjinisë:

Popullsia	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Popullsia	4262	4066	8328	51.2	48.8


Burimi i të dhënave: INSTAT

Popullsia është e ndarë nëpër njësi administrative si më poshtë:

#	Njesia Administrative	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Lukovë	1319	1259	2578	51.2	48.8
2	Himarë	2014	1887	3901	51.6	48.4
3	Hore Varnisht	929	920	1849	50.2	49.8



Burimi i të dhënave: INSTAT





Analfabetizmi

Tabela më poshtë paraqet numrin e personave mbi 10 vjeç që dinë shkrim e lexim:

Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Banorë që nuk dinë shkrim e këndim	79	138	217	36.4	63.6
Banor mbi 10 vjeç	3925	3641	7566	51.9	48.1

Burimi i të dhënave: INSTAT

Nga gjithsej **7,566 banorë mbi moshën 10 vjeç** në Bashkinë Himarë, **217 persona** rezultojnë se **nuk dinë shkrim e lexim**, që përbën rreth **2.9% të popullsisë** në këtë grupmoshë. Brenda këtij grupi, **138 janë gra dhe 79 janë burra**, çka do të thotë se **63.6% e personave që nuk dinë shkrim e lexim janë gra**, ndërsa **36.4% janë burra**.

Nëse krahasojmë këtë shpërndarje me përbërjen gjinore të popullsisë mbi 10 vjeç, ku **51.9% janë burra dhe 48.1% gra**, vërehet një disproporcion i qartë në dëm të grave. Megjithëse femrat përbëjnë një përqindje më të vogël të popullsisë në këtë grupmoshë, ato përfaqësojnë një përqindje dukshëm më të lartë ndër personat që nuk kanë aftësi bazë në lexim dhe shkrim.

Kjo tregon se gratë janë më të ekspozuara ndaj analfabetizmit, sidomos ato që mund t'i përkasin brezave më të vjetër ose që jetojnë në zona të thelluara dhe me akses të kufizuar në arsim. Ky hendek përfaqëson një formë të përjashtimit gjinor nga edukimi bazë, me ndikim të drejtpërdrejtë në mundësinë e grave për të marrë pjesë në jetën ekonomike, sociale dhe publike. Mungesa e aftësive të leximit dhe shkrimit kufizon aksesin e tyre në informacion, punësim, shërbime dhe ushtrimin e të drejtave të tyre.

Ky tregues nënvizon domosdoshmërinë për ndërhyrje të posaçme që synojnë përfshirjen arsimore të grave, përmes programeve të edukimit për të rritur dhe fushatave sensibilizuese në nivel komunitar.



Niveli Arsivor

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit, duke reflektuar tendenca sociale dhe sfida potenciale për barazinë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

Tabela më poshtë paraqet nivelin arsimor të popullatës.

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Asnjë nivel arsimor i përfunduar	20	35	55	36.4	63.6
2	Arsimi Fillor	210	367	577	36.4	63.6
3	Shkollë 9 vjeçare	1321	1380	2701	48.9	51.1
4	Shkollë e mesme	1580	1144	2724	58.0	42.0
5	Bachelor	198	191	389	50.9	49.1
6	Master ose Doktoraturë	156	183	339	46.0	54.0

Burimi i të dhënave: INSTAT

Të dhënat mbi nivelin arsimor të popullsisë në Bashkinë Himarë tregojnë një shpërndarje gjinore që pasqyron dinamika të rëndësishme sociale dhe sfida të vazhdueshme në drejtim të barazisë në arsim. Kjo analizë është e vlefshme për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë për promovimin e barazisë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

Asnjë nivel arsimor i përfunduar – Në këtë kategori përfshihen **55 persona, nga të cilët 63.6% janë gra dhe 36.4% burra**. Gratë përbëjnë shumicën, duke treguar se ato kanë qenë më të prekura nga mungesa e aksesit në arsim, sidomos në të kaluarën apo në zonat më të thella, ku normat sociale dhe përgjegjësitë tradicionale kanë ndikuar në shpërndarjen e tyre të hershme nga shkolla.

Arsimi fillor – Nga gjithsej **577 persona** me vetëm arsim fillor të përfunduar, **63.6% janë gra dhe 36.4% burra**. Kjo shpërndarje e ngjashme me kategorinë e mëparshme sugjeron se një pjesë e madhe e grave ka ndërprerë shkollimin në këtë nivel, çka mund të lidhet me faktorë si presionet familjare, mungesa e infrastrukturës shkollore në afërsi, apo mungesa e mbështetjes për vijimin e mëtejshëm të shkollës.

Shkolla 9-vjeçare – Ky është një nga nivelet më të përhapura të arsimit, me gjithsej **2,701 persona**. Nga këta, **51.1% janë gra dhe 48.9% burra**. Kjo shpërndarje relativisht e balancuar tregon një përmirësim të aksesit në arsimin e detyrueshëm për të dyja gjinitë, veçanërisht në brezat e rinj.

Arsimi i mesëm – Nga **2,724 persona** që kanë përfunduar arsimin e mesëm, **58% janë burra dhe vetëm 42% gra**. Kjo tregon një rënie të ndjeshme të pjesëmarrjes së vajzave krahasuar me arsimin 9-vjeçar dhe përforcon faktin se vajzat ende përballen me barriera për të vazhduar shkollimin pas ciklit të detyrueshëm.




Bachelor – Nga 389 persona me diplomë Bachelor, 50.9% janë burra dhe 49.1% gra. Kjo shpërndarje është pothuajse e barabartë, duke treguar se vajzat që arrijnë të ndjekin shkollën e mesme kanë gjasa të krahasueshme me djemtë për të vazhduar studimet e larta.

Master ose Doktoraturë – Nga 339 persona me këto nivele të larta arsimore, 54% janë gra dhe 46% burra. Gratë përfaqësojnë shumicën, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes së tyre në arsimin akademik të avancuar dhe një tendencë pozitive drejt barazisë në arsim të lartë.

Përmbledhje: Të dhënat tregojnë dy prirje të dallueshme: në nivelet më të ulëta të arsimit, gratë përfaqësojnë një pjesë më të madhe të atyre që nuk kanë përfunduar arsimin bazë; ndërsa në nivelet e larta, përfshirja e tyre është më e lartë dhe në disa raste më e madhe se ajo e burrave. Kjo sugjeron përmirësim në aksesin dhe vijueshmërinë e arsimit për gratë, por gjithashtu tregon se boshllëqet gjinore në arsim vazhdojnë të ekzistojnë në ciklin e ulët dhe të mesëm.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që politikat vendore të përqendrohen në parandalimin e braktisjes shkollore të vajzave, nxitjen e përfshirjes së tyre në arsimin e mesëm dhe promovimin e vazhdimësisë drejt arsimit të lartë. Këto masa janë kyçe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.






Statusi martesor

Tabela me poshte paraqet popullsine mbi 10 vjec sipas statusit martesor

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Beqar(e)	1440	940	2380	60.5	39.5
2	I/e martuar	2572	2441	5013	51.3	48.7
3	I/e divorcuar ose i/e ndarë	96	51	147	65.3	34.7
4	I/e ve	154	634	788	19.5	80.5

Burimi i të dhënave: INSTAT



Shpërndarja sipas statusit martesor në Bashkinë Himarë tregon dallime të dukshme gjinore, që pasqyrojnë norma kulturore, jetëgjatësi dhe dinamika të ndryshme familjare mes burrave dhe grave.

Në kategorinë “beqar(e)”, ka gjithsej 2,380 persona, nga të cilët 60.5% janë burra dhe 39.5% gra. Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të të pamartuarve, çka mund të shpjegohet me prirjen e tyre për t’u martuar më vonë krahasuar me gratë, ose me tendencën për të qëndruar më gjatë në këtë status për arsye ekonomike, personale apo kulturore.

Në kategorinë “i/e martuar”, nga 5,013 persona, 51.3% janë burra dhe 48.7% gra. Kjo shpërndarje është relativisht e balancuar, duke reflektuar përfshirjen e të dy gjinive në institucionin e martesës, megjithatë përqindja pak më e lartë e burrave mund të lidhet me faktorë si migracioni



apo jetëgjatësia më e ulët e burrave, që ndikon në rënien e numrit të grave të martuara në moshë më të madhe.

Në kategorinë **“i/e divorcuar ose i/e ndarë”**, janë regjistruar **147 persona**, ku **65.3% janë burra** dhe **34.7% gra**. Ndryshe nga tendenca kombëtare ku gratë shpesh përbëjnë shumicën e të ndarëve, në Bashkinë Himarë burrat rezultojnë më të shumtë në këtë kategori. Kjo mund të lidhet me normat kulturore mbi stigmatizimin e grave të ndara apo me faktin që burrat më shpesh formalizojnë ndarjen ligjore.

Në kategorinë **“i/e ve”**, ka gjithsej **788 persona**, ku **80.5% janë gra** dhe vetëm **19.5% burra**. Ky dallim i fortë reflekton diferencën në jetëgjatësinë mes gjinive: gratë jetojnë mesatarisht më gjatë dhe rrallë rimartohen pas vdekjes së bashkëshortit. Kjo situatë krijon një grup të ndjeshëm shoqëror me nevoja specifike, që shpesh përballlet me vetminë, mungesën e përkrahjes dhe sfida ekonomike.

Përmbledhje: Të dhënat tregojnë se statusi martesor ndërthuret ngushtë me gjininë, duke krijuar situata të ndryshme për burrat dhe gratë në faza të ndryshme të jetës. Gratë janë veçanërisht të ekspozuara ndaj pasojave sociale dhe ekonomike të të qenit të veja ose të ndara, ndërsa burrat dominojnë në grupin e beqarëve dhe të ndarëve. Këto prire duhet të merren parasysh gjatë hartimit të politikave sociale dhe shërbimeve mbështetëse në nivel vendor, me qëllim fuqizimin dhe mbrojtjen e grupeve më të cënueshme.




Statusi i nënës

Tabela më poshtë tregon numrin e grave që bëhen nëna sipas grupmoshës.

Grupmosha	Kane lindur	Nuk kane lindur	Gjithsej	% kane lindur	% NUK kane lindur
15-24 vjeç	91	689	780	11.7	88.3
25-34 vjeç	501	226	727	68.9	31.1
35-44 vjeç	700	128	828	84.5	15.5
45-54 vjeç	1064	164	1228	86.6	13.4
55-64 vjeç	1412	196	1608	87.8	12.2
65-74 vjeç	970	101	1071	90.6	9.4
mbi 75 vjeç	573	38	611	93.8	6.2

Burimi i të dhënave: INSTAT



Të dhënat mbi lindshmërinë sipas grupmoshës në Bashkinë Himarë tregojnë një shpërndarje të qartë ndërmjet brezave, ku gratë mbi 25 vjeç janë në shumicën dërrmuese nëna, ndërsa përqindja e grave pa fëmijë është dukshëm më e lartë tek grupmoshat më të reja. Ky ndryshim reflekton tendencat moderne, rolet sociale dhe vendimmarrjen individuale të grave në lidhje me riprodhimin.

Në grupmoshën 15–24 vjeç, vetëm 8.2% e vajzave dhe grave kanë lindur fëmijë, ndërsa 91.8% nuk kanë lindur. Kjo është një shifër në përputhje me tendencat bashkëkohore, ku shtyhet mosha e parë e lindjes për shkak të përfshirjes më të madhe në arsim, ndjekjes së karrierës ose përzgjedhjes personale për të mos hyrë herët në rol prindëror.



Në grupmoshën 25–34 vjeç, 62.4% e grave kanë lindur dhe 37.6% jo. Kjo grupmoshë përfaqëson fazën më aktive të jetës riprodhuese, megjithatë përqindja e grave pa fëmijë është ende e konsiderueshme, çka tregon se një pjesë e tyre e shtynë lindjen për arsye të ndryshme personale apo sociale.

Në grupmoshën 35–44 vjeç, 82% e grave kanë lindur fëmijë, ndërsa vetëm 18% nuk kanë lindur. Kjo tregon se pjesa më e madhe e grave në këtë grupmoshë tashmë e kanë përmbushur rolin prindëror në kuptimin tradicional.

Në grupmoshat më të mëdha 45–54 vjeç (88.8%), 55–64 vjeç (93%), 65–74 vjeç (95%) dhe mbi 75 vjeç (95.1%) – lindshmëria arrin në nivele shumë të larta, duke pasqyruar normat sociale të brezave të mëparshëm, ku të qenit nënë ishte një pritshmëri kulturore dhe sociale pothuajse universale për gratë.

Përmbledhje – Kjo shpërndarje tregon një ndryshim të dukshëm ndërbrezor lidhur me normat sociale. Gratë e reja, sidomos ato nën 25 vjeç, në pjesën më të madhe nuk janë ende nëna, çka mund të interpretohet si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes në arsim, përfshirjes në punësim dhe ndryshimeve në rolet gjinore. Ndërkohë, gratë në moshë më të madhe kanë ndjekur modele më tradicionale të jetës familjare dhe janë përfshirë gjerësisht në prindërim.


Ky informacion është i vlefshëm për të kuptuar nevojat sociale të grave në faza të ndryshme të jetës. Gratë e reja mund të kenë nevojë për mbështetje në planifikimin familjar, akses në informacion mbi shëndetin riprodhues dhe programe që lehtësojnë balancimin e karrierës me jetën personale. Ndërkohë, gratë që janë ose kanë qenë nëna mund të kenë nevojë për përkrahje në përkujdesjen për fëmijët, përfitime sociale dhe ndihmë në sfidat e mëvonshme të jetës familjare.

Frekuentimi i çerdhes

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin çerdhen.

#	Emërtimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek Cerdhen	30	41	71	42.3	57.7
2	NUK ndjek cerdhen	59	63	122	48.4	51.6

Burimi i të dhënave: INSTAT



Nga gjithsej **193 fëmijë** të moshës 0–3 vjeç në territorin e Bashkisë Himarë, **71 fëmijë** (rreth **36.8%**) ndjekin çerdhen, ndërsa **122 fëmijë** (rreth **63.2%**) nuk ndjekin këtë shërbim.

Ndër fëmijët që ndjekin çerdhen, **57.7% janë vajza** dhe **42.3% djem**. Edhe pse diferenca nuk është shumë e madhe, përqindja më e lartë e vajzave tregon një prirje të lehtë drejt përfshirjes më të madhe të vajzave në çerdhe.

Tek ata që **nuk ndjekin çerdhen**, **51.6% janë vajza** dhe **48.4% djem**, duke treguar gjithashtu një shpërndarje relativisht të barabartë gjinore, pa dallime të theksuara në aksesin ndaj këtij shërbimi.

Ajo që bie më shumë në sy është se **vetëm rreth 1 në 3 fëmijë** të kësaj grupmoshe ndjekin çerdhen, ndërsa pjesa më e madhe (**63.2%**) nuk përfitojnë nga ky shërbim. Kjo përqindje e ulët mund të shpjegohet me mungesën e çerdheve publike ose kapacitetet e kufizuara, koston për familjet, distancën gjeografike të institucioneve apo normat tradicionale që nxisin kujdesin në shtëpi, zakonisht nga nëna ose anëtarë të tjerë të familjes.

Kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, pasi mungesa e aksesit në çerdhe kufizon aftësinë e prindërve – kryesisht të grave – për të ndjekur punësimin, arsimin ose pjesëmarrjen në jetën publike. Gratë mbajnë shpesh barrën kryesore të kujdesit për fëmijët e vegjël, krahas përmbushjes së roleve tradicionale gjinore në familje, siç janë kujdesi për shtëpinë dhe për anëtarët e tjerë të familjes, veçanërisht për të moshuarit. Në mungesë të mbështetjes institucionale, këto përgjegjësi ndikojnë ndjeshëm në kufizimin e mundësive të tyre për zhvillim personal dhe profesional.



Prandaj, kjo analizë nënvizon nevojën për zgjerim të shërbimeve të çerdheve dhe për politika lokale që e bëjnë këtë shërbim më të aksesueshëm dhe të përballueshëm për të gjitha familjet – si një masë konkrete për të promovuar barazinë gjinore dhe mbështetjen e familjes në kujdesin ndaj fëmijëve.

Frekuentimi i Kopshtit

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që ndjekin kopshtin.

#	Frekuentimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek kopshtin	46	58	104	44.2	55.8
2	NUK ndjek kopshtin	45	39	84	53.6	46.4

Burimi i të dhënave: INSTAT

Të dhënat mbi frekuentimin e kopshteve në Bashkinë Himarë tregojnë se **një numër i konsiderueshëm fëmijësh (84 gjithsej)** nuk ndjekin kopshtin, ndërsa **104 fëmijë** janë të përfshirë në këtë shërbim parashkollor.

Ndër ata që ndjekin kopshtin, **vajzat përbëjnë 55.8%**, ndërsa djemtë **44.2%**. Kjo tregon një përfaqësim më të lartë të vajzave në kopsht krahasuar me djemtë, një tendencë që del jashtë modeleve më të zakonshme, ku vajzat janë shpesh më pak të përfshira.

Ndër fëmijët që **nuk ndjekin kopshtin, 53.6% janë djem dhe 46.4% vajza**, gjë që tregon se në këtë kontekst, janë më shumë djem që mbeten jashtë sistemit parashkollor. Megjithatë, përqindja e përgjithshme e fëmijëve që nuk ndjekin kopshtin është ende e lartë, dhe kjo ka ndikime të drejtpërdrejta gjinore.

Kjo situatë ndikon veçanërisht **te nënat**, të cilat në shoqërinë shqiptare mbajnë përgjegjësinë kryesore për kujdesin ndaj fëmijëve të vegjël. Prandaj:

- Nënata e fëmijëve që nuk ndjekin kopshtin kanë më pak mundësi për të ndjekur karrierën ose për të qenë të punësuar me kohë të plotë;
- Mungesa e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor, edhe kur ndodh më shpesh me djemtë, **vazhdon të përforcojë pabarazitë gjinore**, duke e vendosur barrën e kujdesit mbi gratë;
- Situata përkeqësohet nëse nuk ka alternativa publike cilësore, apo nëse normat kulturore i përjashtojnë fëmijët nga arsimi i hershëm.

Kështu, të dhënat e Bashkisë Himarë zbulojnë një prirje që mund të çojë në **vazhdimësinë e ciklit të pabarazisë gjinore**: fëmijët mbeten jashtë kopshtit → nënat mbajnë barrën e kujdesit → gratë kufizohen në punësim dhe zhvillim profesional → rritet varësia ekonomike dhe sociale.

Kjo tendencë duhet të merret në konsideratë në planin për barazinë gjinore të Bashkisë Himarë, me ndërhyrje konkrete për të:



- rritur përfshirjen e fëmijëve, sidomos në zonat ku përqindja e pjesëmarrjes është e ulët,
- zgjeruar dhe përmirësuar kapacitetet e kopshteve publike,
- ofruar lehtësira për prindërit punonjës, si orare fleksibël dhe mbështetje financiare, dhe
- promovuar ndarjen e drejtë të kujdesit brenda familjes, duke sfiduar normat tradicionale që e ngarkojnë vetëm gruan.


Këto masa janë thelbësore për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve dhe për të promovuar barazinë gjinore në praktikë.

Persona me Aftësi të Kufizuar

Tabelat më poshtë tregojnë numrin e personave me aftësi të kufizuara në bashki, në total dhe të ndarë sipas llojit të vështirësisë.

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
5-14 vjec	2	5	7	28.6	71.4
15-64 vjec	81	92	173	46.8	53.2
mbi 65 vjec	238	284	522	45.6	54.4

Burimi i të dhënave: INSTAT



Të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Himarë tregojnë një **prirje të qartë gjinore**, e cila duhet të merret në konsideratë në planifikimin e politikave sociale dhe të barazisë gjinore.



Në grupmoshën **5–14 vjeç**, numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara është i ulët (vetëm 7 raste), por **vajzat përbëjnë 71.4%**, duke sinjalizuar se edhe në këtë moshë të hershme, vajzat janë më të prekura dhe mund të përballen me pengesa më të mëdha në qasjen në arsim dhe zhvillim.

Në grupmoshën **15–64 vjeç**, **53.2% e personave me aftësi të kufizuara janë gra**, ndërsa në grupmoshën **mbi 65 vjeç**, kjo përqindje është **54.4%**. Këto të dhëna tregojnë se me rritjen e moshës, gratë përfaqësohen më shumë në këtë kategori. Kjo reflekton **jetëgjatësinë më të madhe të grave**, por edhe faktin që ato përballen më shpesh me **kushte shëndetësore të patrajtuara**, mungesë mbështetjeje dhe barrë disproporcionale të kujdesit gjatë jetës së tyre.

Diferencat gjinore theksohen edhe më tej kur të dhënat analizohen sipas **llojit të vështirësisë**:

- Në **vështirësitë në ecje**, **55.6% e personave të prekur janë gra**, çka përbën grupin më të madh dhe tregon ndikim të drejtpërdrejtë në lëvizshmëri dhe pavarësi.
- Në **vështirësitë në shikim**, gratë përfaqësojnë **53.4%**, një përqindje më e lartë krahasuar me burrat.
- Në të tjera kategori si **dëgjimi, kujtesa, kujdesi ndaj vetes dhe komunikimi**, përqindjet janë relativisht të balancuara, megjithatë burrat janë pak më të përfaqësuar.

Kjo tregon se **gratë me aftësi të kufizuara përballen me sfida të shumëfishta**, si kufizime fizike, vështirësi ekonomike, mungesë aksesesh në shërbime dhe pengesa kulturore. Ato shpesh përjetojnë një **formë të dyfishtë të diskriminimit** – si gra dhe si persona me aftësi të kufizuara – duke u përjashtuar nga pjesëmarrja e barabartë në jetë sociale, arsimore dhe ekonomike.

Këto të dhëna nënvizojnë domosdoshmërinë që Bashkia Himarë të:

- sigurojë **infrastrukturë të aksesueshme** në të gjitha hapësirat publike dhe institucionet,
- ofrojë **mbështetje të specializuar shëndetësore, sociale dhe emocionale**, veçanërisht për gratë,
- nxisë **punësimin dhe pavarësinë ekonomike të grave me aftësi të kufizuara**,
- garantojë **mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna** dhe përfshirjen e kësaj kategorie në të gjitha politikat lokale.


Përfshirja aktive e grave me aftësi të kufizuara në hartimin dhe zbatimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore është thelbësore, në mënyrë që masat të jenë të ndjeshme, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjinisë apo aftësisë.

#	Lloji i vështirësisë	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Në shikim	130	149	279	46.6	53.4
2	Në dëgjim	117	100	217	53.9	46.1
3	Në ecje	209	262	471	44.4	55.6
4	Kujtesë	98	87	185	53.0	47.0



5	Kujdesin e përditshëm ndaj vetes	106	92	198	53.5	46.5
6	Në komunikim	72	63	135	53.3	46.7

Burimi i të dhënave: INSTAT





Situata e shërbimeve sociale

Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë është pjesë e strukturës së Bashkisë Himarë ku është ndarë në dy sektore atëherë të mbrojtës sociale, arsimit dhe rinisë si dhe në sektorin e nga sektorët i ndihmës sociale dhe strehimit.¹

Bashkia Himarë ka një person të dedikuar dhe i vendosur në strukturën e bashkisë për çështjet që lidhen me Dhunën në Familje (DHF) i cili mbulon dhe çështjet e Barazisë Gjinore (BGJ).

Bashkia Himarë në Tetor të vitit 2017 ka formalizuar Mekanizmin e Koordinuar të Referimit përmes nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse për këtë qëllim ndërmjet 12 institucioneve anëtare, si një mundësi për të zhvilluar më tej konceptin e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar. Në këtë kuadër është mundësuar trajnimi dhe mbështetja e koordinatorit vendor kundër dhunës në marrëdhënie familjare dhe anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisiplinor.²

¹ <https://himara.gov.al/njoftim-fituesi-per-kategorine-e-ulet-dhe-te-mesme-drejtuese-pergjegjes-sektori-ne-sektorin-e-ndihmes-sociale-dhe-strehimit-ne-drejtorene-e-ceshtjeve-sociale-arsimit-dhe-rinise/>

² Referuar nga Bashkia Himarë.



Metodologjia

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e bashkisë, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmoshave, niveli arsimor, normat e analfabetizmit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuara, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit.

Analiza mori gjithashtu në konsideratë diferencat midis zonave urbane dhe rurale të territorit të bashkisë, për të kuptuar nëse sfidat gjinore janë homogjene apo të ndikuara nga konteksti gjeografik dhe social. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e nevojave të ndryshme në nivel njësie administrative dhe krijoi bazën për përshtatjen e ndërhyrjeve në planin e veprimit.

Në aspektin institucional, u analizua struktura ekzistuese dhe funksionaliteti i mekanizmave për barazinë gjinore brenda bashkisë. Konkretisht, u shqyrtua nëse bashkia kishte miratuar Kartën për Barazinë Gjinore, nëse Komisioni për Barazi Gjinore pranë Këshillit Bashkiak ishte funksional, dhe nëse Aleanca e Grave Këshilltare ishte aktive dhe me mbështetje buxhetore. Po ashtu, u vlerësua ekzistenca dhe roli i punonjësit të barazisë gjinore brenda administratës, pozicionimi i tij në strukturë (veçmas apo i lidhur me dhunën në familje), dhe çfarë roli dhe detyrash janë përcaktuar në përshkrimet e punës apo në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë ka qenë edhe vlerësimi i kapacitetit për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet publike, përmes ngritjes së një Komisioni të Administratës për Barazi Gjinore. U vlerësua nëse komisioni ekziston, është ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka



nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologji ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.



Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

Qëllimet dhe objektivat strategjike

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë 2026–2028 ndërtohet mbi **qëllime strategjike**, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Këto qëllime janë të përkthyer në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, që mund të zbatohen, monitorohen dhe matën përgjatë një periudhe trevjeçare.

Qëllimi Strategjik 1 (Q1):

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon të konsolidojë qeverisjen vendore duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një komponent funksional dhe të domosdoshëm të mënyrës se si organizohen, menaxhohen dhe zhvillohet bashkia. Në këtë kuadër, barazia gjinore nuk konceptohet si një qëllim i izoluar, por si një qasje ndërsektoriale që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse, planifikuese, menaxheriale dhe raportuese të qeverisjes vendore.

Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjta në shërbimet publike.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet që zhvillohen nga institucionet publike, si dhe në mënyrën se si komunikohet dhe bashkëpunohet me qytetarët. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e mekanizmave të brendshëm për monitorim dhe llogaridhënie, si dhe fuqizimin e rolit të aktorëve vendor, përfshirë këshillat bashkiakë, administratën vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin, në promovimin e barazisë gjinore si një element i padiskutueshëm i qeverisjes së mirë.



Qëllimi Strategjik 1 përfshin tre objektiva specifike:

1. Objektivi Specifik (O1.1) Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.
2. Objektivi Specifik (O1.2) Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.
3. Objektivi Specifik (O1.3) Të nxitet dhe zgjerohet pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, në nivel lokal. Qëllimi Strategjik 2 (Q2):

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përbalueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cënueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Ky qëllim kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

Qëllimi Strategjik 2 (Q2):

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.

Qëllimi Strategjik 2 konkretizohet në katër objektiva specifike:

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.



1. Objektivi Specifik (O2.1) Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.
2. Objektivi Specifik (O2.2) Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinor dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.
3. Objektivi Specifik (O2.3) Të përmirësohet siguria dhe cilësia e jetës në hapësirat publike urbane dhe rurale, përmes dizajnit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe krijimit të mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë.
4. Objektivi Specifik (O2.4) Të sigurohet përfshirja e barabartë gjinore në jetën kulturore, letrare dhe sportive të komunitetit, përmes aksesit të drejtë në infrastrukturë, përmbajtje promovuese dhe programe pjesëmarrëse për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.



Plani i Veprimit

Qëllimi Strategjik: 1

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon ta bëjë barazinë gjinore një pjesë përbërëse të kulturës institucionale të bashkisë, duke e integruar në strukturat, praktikatat dhe komunikimin publik. Ai përfshin tre objektiva specifike:

Qëllimi strategjik 1:

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Objektivi Specifik (O1.1) Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.					
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë dhe të KBRE-së.	2026	Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare web të bashkisë; IT l/e bashkisë	Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare	0 lekë (faqe web, staf teknik)	Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare
1.1.2 Hartimi i udhëzimeve dhe tabelave të treguesve për monitorim.	2026	Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e performancës	Njësia përgjegjëse për hartimin e statistikave/performancës	0 lekë	Dokument i përfunduar dhe shpërndarë në drejtoritë përkatëse



1.1.3 Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të dhënave me tregues gjinorë.	2026 - 2028	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT, donatorë	180,000 lekë (trajnerë + logjistikë)	Numri i punonjësve të trajnuar dhe vlerësimi pas-trajnit
1.4.5 Përfshirja në rubrikën përkatëse të seksionit për konsultime publike për buxhetimin dhe nxitjen e pjesëmarrjen gjinore	2026	Njësia përgjegjëse për hartimin e Buxhetit Afatmesëm	Njësitë Administrative, Aleanca e Grave Këshilltare	0 lekë	Seksioni funksional dhe pjesëmarrje gjinore në konsultime
1.4.6 Kalendar Lokal dhe organizim i aktiviteteve për Ditët Ndërkombëtare të të Drejtave të Grave dhe DHF	Viti 2026 (i përsëritshëm çdo vit)	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, OJF lokale, Bashkia Himarë	200,000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i aktiviteteve të organizuara sipas kalendarit
1.4.7 "Buxheti i Barazisë": simulim edukues në shkollë të mesme ku nxënësit mësojnë të planifikojnë buxhetin publik me lente gjinore.	2026-2027	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, Bashkia Himarë	50.000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i simulimeve të organizuara në shkollë
1.4.8 "Ndal! Fjalor gjinor": nxënësit dhe komuniteti identifikojnë e zëvendësojnë fjalët diskriminuese.	2026-2027	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, Bashkia Himarë	50.000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i aktiviteteve të organizuara në shkollë dhe komunitet

Objektivi Specifik (O1.2) Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.					
Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjësi	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.2.1 Ngritja e funksionalizimi i Komisionit për BGJ në nivel Bashkie dhe përfshirja e Koordinatorit për BGJ në strukturën e Drejtorisë dhe Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	2026	Kryetari i Bashkisë	Drejtuuesit e Drejtorive, Këshilli Bashkiak	80,000 lekë (mbledhje, dokumente, koordinim, orë punë)	Komisioni aktiv dhe mbledhje periodike të dokumentuara
1.2.2 Trajnim për anëtarët e Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie. (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.	2026	Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Ekspertë të kontraktuar	100,000 lekë (trajnerë, logjistikë, materiale)	Numri i trajnimeve dhe përfshirja e anëtarëve
1.2.3 Program trajnimi për zyrtarët bashkiakë mbi barazinë gjinore dhe anti-diskriminimin sipas një kalendarit vjetor të miratuar.	2026 - 2028	Drejtorja e Burimeve Njerëzore	Shkolla e Administratës Publike	300,000 lekë/vit (paketa trajnuese, fasilitatorë, certifikime)	Numri i trajnimeve të zhvilluara sipas kalendarit vjetor
1.2.4 Draftimi dhe miratimi një politike lokale kundër ngacmimit seksual dhe diskriminimit (PSEA)	2026 - 2028	Drejtorja e Burimeve Njerëzore & Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Donatorë & OJF	30.000 (experti, takime, facilitime te aktivitetit)	Dokumenti i plotikave i miratuar



Objekti i Specifik (O1.3) Të nxitet dhe zgjerohet pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, në nivel lokal.					
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.3.1 Takime informuese me administratorët shoqërorë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesa.	2026	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & Njësitë Administrative	10,000 lekë (organizim, materiale, orë pune)	Numri i takimeve dhe pjesëmarrësve përfaqësues
1.3.2 Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rolet gjinore në komunitete rurale dhe lagje urbane.	2026 – 2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & Njësitë Administrative	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & Njësitë Administrative, Shkolla, OJF dhe grupet e interesit	100,000 lekë (postera, aktivitete, facilitim, orë pune)	Numri i fushatave dhe zonat e mbuluara
1.3.4 Organizimi i konsultimeve periodike dhe të rregullta me organizatat e grave dhe grupet në nevojë për probleme dhe sfida në ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike lokale.	2026 e në vijim	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Zyra për Marrëdhënie me Komunitetin	Grupime komunitare, OJF, përfaqësues të shërbimeve	10,000 lekë/vit (takime, raporte, koordinim, orë pune)	Numri i konsultimeve dhe temat e adresuara në shërbimet publike
1.3.5 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse me	2026 – 2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale,	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & Njësitë	50.000 lek(aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i fushatave ndërgjegjëse të zhvilluara

fokus përfshirjen e burrave dhe djemve si aleatë për barazinë gjinore	2028	Arsimit dhe Rinisë & Njësitë Administrative	Bashkia Himarë
1.3.6 "Një ditë si ajo": eksperiment social për zyrtarët vendorë për të përjetuar një ditë tipike të një gruaje në bashki për të nxitur vetëdijësimin institucional.	2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & Njësitë Administrative	20.000 (Organizim logjistik dhe koordinim i eksperimentit, Shpenzime transporti për lëvizjet e simuluar)
			Numri i eksperimenteve sociale



Qëllimi strategjik 2:

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.

Objekti i Specifik (O2.1) Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.					
Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të NJVRR (Njësitë Vendore të Referimit dhe Reagimit) për çdo njësi administrative	2026	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Njësitë Administrative, Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Policia, Shërbimi Shëndetësor	10,000 lekë/vit (takime, raporte, koordinim, orë pune	Numri i strukturave NJVRR të ngritura dhe funksionale në njësi administrative
2.1.2 Ndërgjegjësim i të rinjve mbi prindërimin e balancuar gjinor.	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit Rinisë ZVA dhe shkollat e mesme, Donatorë dhe OJF	20.000 lek (Materiale promovuese (postera, etiketa, fletëpalosje, konsum për zyrtarët pjesëmarrës)	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit
2.1.3 Krijimi programi vijtor të granteve të vogla	2026-2028	Drejtoria e Cështjeve	Bashkia Himarë	1,200,000 lekë/3 vite (fond për grante, promocion,	Numri i granteve të dhëna; % e përfituesve nga zonat rurale



për nxitjen e nismave sociale dhe bizneseve të vogla të grave (me vëmendje për zonat rurale)		Sociale, Arsimit Rinisë		ndihmë teknike, lehtësi fiskale)	
2.1.4 Zhvillimi i një programi të dedikuar trajnimit për vajza dhe djem të rinj, me fokus në zhvillimin e aftësive për ofrimin e shërbimeve në sektorin e turizmit, si një mundësi për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit.	2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Bashkia Himarë Zyra vendore AKPA Drejtoria rajonale formimit profesional	200.000 leke (Pagesë për trajnerë Materiale promovuese, postera, etiketa, fletëpalosje, konsum për zyrtarët pjesëmarrës	Numri i programeve të reja të trajnimeve
2.1.5 Krijimi dhe funksionalizimi i një njësie lëvizëse për ofrimin e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale në banesë, me fokus të veçantë tek grate e vetmuara (të veja dhe të moshuara) dhe personat me AK, me qëllim përmirësimin e aksesit në shërbime bazë dhe rritjen e përfshirjes sociale të këtyre grupeve vulnerabël.	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Njësitë përgjegjëse, shërbimet publike	Njësitë Administrative		Numri i grave dhe burrave përfitues
2.1.6 Zhvillimi i moduleve të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në bashkëpunim me ZVA dhe shkollat fillore	2026-2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	ZVA, OJF edukative, mësues të përzgjedhur	180,000 lekë (modulim materialësh, trajnim I mësuesve, monitorim)	Numri i moduleve të zhvilluara dhe numri i shkollave pjesëmarrëse

2.1.7 Ofrimi e këshillimit të karrierës për vajzat e djemtë dhe ndërgjegjësim për rolet dhe profesionet gjinore.	2026-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	ZVA, shkolla 9 vjeçare dhe te mesme Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë;	180.000 lekë (modulim materialesh, trajnim i mësuesve dhe nxenesve, monitorim)	Numri i sesioneve të këshillimit
2.1.8 Mbështetje për gratë në bujqësi përmes skemave të granteve dhe aksesit në kredi me kushte lehtësuese.	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Njësia e Buxhetit, Njësia e Bujqësisë, OJF	100.000 leke (Organizimi i seancave informuese locale, materiale informuese, fletëpalosje, broshura, ekspert për ndihmë në aplikime/grante, krijimi i një skeme simbolike mbështetëse, shpenzime koordinimi dhe promovimi)	Numri i grave që kanë përfituar grante në bujqësi
2.1.9 "Harta e Bizneseve të Grave": platformë online për promovimin dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse.	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	IT, OJF	200.000 leke (Konceptim dhe dizajn i platformës, programues për zhvillim web, trajnim për gratë mbi përdorimin e platformës)	Platforma elektronike online
2.1.10 Formim profesional për vajzat dhe gratë në	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale,	AKPA	100.000 leke (Pagesë për trajnerët, materiale për kurset, transport/stipendë	Numri i vajzave dhe grave që kanë zhvilluar kurse profesionale.

profile të kërkuara nga tregu lokal i punës	Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria rajonale formimit profesional	simbolike për pjesëmarrëse, certifikim dhe promovim)	
2.1.11 “Gratë që frymëzojnë qytetin tim”: Promovimi i figurave aktive dhe model të grave të komunitetit lokal	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Bashkia Himarë	50.000 leke (Intervistim dhe dokumentim, video + foto profesionale, postera, rrjete sociale, ekspozim, aktivitet prezantues publik me komunitetin, çmime simbolike për gratë e nderuara)	Numri i aktiviteteve promovuese të zhvilluara
2.1.12 Krijimi i memorialeve dhe organizimi i ekspozitave për figura historike femërore me ndikim në qytetin dhe historinë e Bashkisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Bashkia Himarë	100.000 lek (Kërkim historik, përzgjedhje figurash, përgatitje ekspozite, organizim i ekspozitës në një ambient publik, publicitet dhe përfshirje shkollave në ekspozitë)	Numri i memorialeve dhe ekspozitave të zhvilluara.
2.1.13 “Barazi në tokë”: program për të drejtat pronësore të grave në zonat rurale, me ndihmë ligjore dhe fushata ndërgjegjësimi.	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Bashkia Himarë	200.000 lek (organizim fushate sensibilizuese (3 njësi administrative), broshura, postera, ekspert ligjor për këshillim + asistencë,	Numri i grave që kanë përfituar ndihmë ligjore dhe fushata ndërgjegjësimit.



						takime komunitare me gra dhe burra, mbështetje për procedura administrative për raste pilot)	
--	--	--	--	--	--	---	--

Objektivi Specifik (O2.2) Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinor dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.						
Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues	
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokollit të ri të ndjeshëm gjinor për reagim në raste diskriminimi gjinor, dhe dhune mbi bazë gjinore.	2027	Njësia përgjegjëse për shërbimet	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; Qendra Shëndetësore, OJF, Ministria e Shëndetësisë	200,000 lekë (ekspertizë ligjore dhe sociale, konsultime)	Dokument protokollit i miratuar dhe i shpërndarë në strukturat vendore	

2.2.2 Fushatë ndërgjegjësimi për dhunën me bazë gjinore.	2026-2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	30.000 lek (Dizajn dhe printim materialesh (poster, broshura, banderola), spot sensibilizues për rrjetet sociale, aktivitet publik/ditë sensibilizimi (në 1 zonë qendrore), pjesëmarrje e të rinjve/shkollave me pankarta/mesazhe	Numri i fushatave të ndërgjegjësimi
2.2.3 Krijimi i një sistemi gatishmërie për rastet emergjente 24/7	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	20.000 leke (hartimi i protokollit të përgjigjes emergjente, trajnim për personelin përgjegjës në bashki/MKR, material informues me kontaktin emergjent (poster + rrjete sociale)	Krijimi i një sistemi gatishmërie për rastet emergjente 24/7
2.2.4 Trajtime për mësuesit, policinë dhe mjekët për identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në nivel lokal	2026-2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	20.000 lek (trajnerë ekspertë për 3 module trajnimi, kafe, materiale, certifikata, printim manualesh dhe udhëzues praktik për secilin grup, shpenzime	Numri i trajnimeve të zhvilluara. Numri i të trajnuarve.

				organizative dhe raportimi)	
2.2.5 Ndihmë integrale për viktimat e dhunës me bazë gjinore (psikolog, ndihmë ligjore, strehim emergjent)	2026-2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF,	100.000 lek (Pagesa për konsulencë ligjore dhe ndihmë për dokumentacion, këshillim psikologjik me profesionistë, akomodim i përkohshëm në rastet urgjente, mbështetje ekonomike fillestare (paketa ushqimore, higjienike)	Numri i seancave të shërbimit psiko-social, ndihmë ligjore, strehim emergjent të ofruara në vit, për viktimat e dhunës
2.2.6 Forcimi i MKR dhe rritja e eficientes.	2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; OJF	30.000 lek (Trajnim për anëtarët e MKR mbi standardet e reja, përditësimi i protokolleve të bashkëpunimit, mbledhje periodike dhe përgatitje raportimesh, pajisje për	



					MKR (kompjuter, printer, dosje pune, etj.)	
2.2.7 Konsulencë psikologjike falas për çështjet e diskriminimit gjinor;	2026–2027	Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Qendra Ligjore e Ndihmës Falas,	250,000 lekë/vit (pagesa për ekspertë, zyra këshillimi, informim publik)	Numri i rasteve të trajtuara dhe këshillimeve të ofruara	



Objekti i Specifik (O2.3) Të përmirësohet siguria dhe cilësia e jetës në hapësirat publike urbane dhe rurale, përmes dizajnit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe krijimit të mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë.					
Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjësi	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.3.1 Zbatimi i nismes 'Qytete të sigurta për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë' në 3 lagje pilot përmes ndriçimit, sinjalistikës dhe shenjimit të hapësirave publike të sigurta.	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për projektet e Urbanistikës dhe Infrastrukturës	OJF për të drejtat e grave	1,000,000 lekë (projekt teknik, ndriçim, sinjalistikë, promovim, orë pune)	Numri i lagjeve të përfshira dhe ndërhyrjet infrastrukturore të realizuara
2.3.2 Zonifikim i hapësirave të sigurta për gratë në qytet	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për projektet e Urbanistikës dhe Infrastrukturës	OJF për të drejtat e grave	100.000 lek (hartimi i një analize ne bashkëpunim me urbanistë për identifikimin e zonave problematike pjesëmarrëse (workshop + pyetësor), ndriçim simbolik ose sinjalistikë në një zonë pilot)	Numri i hapësirave të sigurta për gratë në qytet



Objekti i Specifik (O2.4) Të sigurohet përfshirja e barabartë gjinore në jetën kulturore, letrare dhe sportive të komunitetit, përmes aksesit të drejtë në infrastrukturë, përmbajtje promovuese dhe programe pjesëmarrëse për gratë, burrat, vajzat dhe djemtet.

Aktivitet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.4.1 Pasurimi i aktiviteteve kulturore, sportive, artistike të cilat theksojnë rolin pozitiv të grave dhe burrave në fusha të ndryshme, si dhe promovimi i vlerave të barabartë gjinor përmes mbështetjes së nismave	2026 - 2028	Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	OJF kulturore	120,000 lekë (promovim, aktivitete, orë pune)	Numri i aktiviteteve të realizuara; numri i aktiviteteve kulturore
2.4.2 Promovimi i aktiviteteve kulturore për barazi gjinore	2026 - 2028	Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Drejtorja e Turizmit, Kulturës, dhe Sportit	Shkolla, OJF, klube rinore	80,000 lekë (materiale, takime diskutimi, orë pune)	Numri i klubeve funksionale, qendrat rinore dhe pjesëmarrësve (sipas gjinisë)

2.4.3 Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në veprimtari kulturore e sportive përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe programeve të përshtatura të ndjeshme ndaj gjinisë	2026 -2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Drejtoria e Turizmit, Kulturës, dhe Sportit	OJF, NJA	900,000 lekë (rindërtime të vogla, programe, trajnime)	% e grave dhe burrave që marrin pjesë në aktivitete; numri i ambienteve të përshtatura
2.4.4 Mbështetje për gratë në bujqësi përmes skemave të granteve dhe aksesit në kredi me kushte lehtësuese	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Bashkia Himarë	100.000 lek (Organizim i 3 sesioneve informuese në zona rurale, angazhimi i një eksperti për ndihmë në aplikim/grante, materiale informuese dhe guida praktike, krijimi i një granti simbolik pilot për 10 gra (300 €/secila), promovim dhe rrjetëzim me institucione financiare)	Numri i grave që janë mbështetur me skemën e granteve.



6. Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, pjesëmarrëse dhe të bazuar në të dhëna.

6.1 Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

6.2 Aktorët përgjegjës

- **Koordinatori për barazinë gjinore** do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.
- **Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (KBGJ)** do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

6.3 Treguesit e progresit

Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore në aktivitete, numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale).

6.4 Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.



6.5 Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave gjinore dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

6. Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.

Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe e rinisë

Aida Halilaj

Drejtoria juridike

Ardit Muhametaj

Drejtoria e financës dhe planifikimit të buxhetit

Laert Mezani

Konceptoi: Andonia Rondo

Pranoi : Nestur Velço